VENDIM
Nr.615, datë 11.6.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË NË AKADEMINË E ARTEVE, NË UNIVERSITETIN " ALEKSANDËR XHUVANI", ELBASAN DHE NË UNIVERSITETIN " FAN S. NOLI", KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Muzikës, në Akademinë e Arteve, si më poshtë vijon:

a) "Pedagogji muzikore", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP.

b) "Fizarmonikë klasike", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP.

2. Hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, sipas fakulteteve, si më poshtë vijon:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës: "Teknologjitë e informacionit", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP.

b) Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit: "Edukim fizik e sporte", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP.

3. Hapjen e programit të studimit "Teknologji e prodhimit bimor", në Fakultetin e Bujqësisë, në universitetin "Fan S. Noli" , Korçë, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP.

4. Programet e studimit të ciklit të parë realizohen në 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

5. Këto programe studimi të ciklit të parë ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar, respektivisht, për Akademinë e Arteve, universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan dhe universitetin " Fan S. Noli", Korçë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Akademia e Arteve, universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan dhe universiteti "Fan S. Noli", Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha